

Jr. 2363 Prot
dt: 19.07.2022



N. K...
D. IT...
26.07.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS
"LUIGJ GURAKUQI"
Fakulteti i Shkencave të Edukimit

Dekani

Nr. 756 prot.

Shkodër, më 19. 07. 2022

Lënda: Propozim për datat e zhvillimit të konkursit të pranimit në programet e studimit të ciklit të parë (Bachelor), viti akademik 2022 – 2023.

REKTORATIT TË USH-së

Bazuar në Urdhërin e përbashkët (QSHA dhe RAS) nr. 8, datë 30.06.2022 "Për miratimin e kalendarit për procesin e aplikimit dhe të regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2022 – 2023" B, pika 4 dhe propozimet e departamenteve qw mbulojnë kwto programe studimi, propozojmë që konkurset e pranimit në programet e studimit të ciklit të parë (Bachelor) në Edukim Fizik e Sporte, në Pikturë dhe grafikë dhe Pedagogji muzikore, të jenë:

1. Konkurset e pranimit në programet e studimit të ciklit të parë (Bachelor), viti akademik 2022 – 2023, në Pikturë dhe Grafikë dhe Pedagogji Muzikore do të zhvillohen më datat 22.08.2022 dhe 23.08.2022.
2. Regjistrimet për konkurset e pranimit në programet e studimit të ciklit të parë (Bachelor), viti akademik 2022 – 2023, në Pikturë dhe Grafikë dhe Pedagogji Muzikore do të jenë më datat 18.08.2022 dhe 19.08.2022, pranë sekretarisë mësimore nga ora 08⁰⁰-13⁰⁰.
3. Konkurset e pranimit në programin e studimit të ciklit të parë (Bachelor), viti akademik 2022 – 2023, në Edukim Fizik dhe Sporte, do të zhvillohet më datën 22.08.2022.
4. Regjistrimet për konkurset e pranimit në programet e studimit të ciklit të parë (Bachelor), viti akademik 2022 – 2023, në Edukim Fizik e Sporte do të jenë më datat 18.08.2022 dhe 19.08.2022, pranë sekretarisë mësimore nga ora 08⁰⁰-13⁰⁰.
5. Të gjithë aplikantët që duan të konkurojnë në programet e studimit të ciklit të parë (Bachelor), në Edukim Fizik e Sporte, në Pikturë dhe grafikë dhe Pedagogji muzikore, duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Dokumentin e identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë), në dosje mbahet vetëm fotokopja.
 - 2 (dy) fotografi.
 - Mandat pagese e tarifës me vlerë prej 5 000 lekë (posta shqiptare).
 - Raport mjeko – ligjor (vetëm për konkurentët në Edukim Fizik e Sporte).

Dekani
Prof. dr. Fahir Vadoher



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
DEPARTAMENTI EDUKIM FIZIK DHE SPORTE

Nr. 137 Prot.

Shkodër, më 14.07.2022

Lënda: Shkresë përcjellese e shpalljes së datës së Konkursit për pranimet e reja në Programin Bachelor në Edukim Fizik e Sport për vitin akademik 2022-2023.

Drejtuar: Dekanit të FSHE, prof.dr. Fatmir Vadohej

Bazuar mbi shkresën e MAS nr.8, dt.30.06.2022, "Për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2022-2023" njoftojmë se: Konkursi për pranimet e reja në Programin Bachelor në Edukim Fizik e Sport, për vitin akademik 2022-2023, do të zhvillohet me dt. **22.08.2022**, ora **9.00** pranë Palestrës së USH.

Faleminderit për bashkëpunimin!

Përgjegjësi i Departamentit

Dr. Gjulio ZEFI

dt: 19.07.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Fakulteti i Shkencave të Edukimit
Departamenti i Arteve

Nr. 142 prot.

Shkodër, më 19.07.2022

Lënda: Propozim për datat e konkurseve në programet e studimit "Pëdagogji Muzikore" dhe "Pikturë dhe grafikë"

Drejtuar: Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Edukimit prof.dr. Fatmir Vadohej

Konkurset e pranimit në programet e studimit "Pedagogji Muzikore" dhe "Pikturë dhe grafikë", rraundi i pare, për vitin akademik 2022-2023, propozoj të zhvillohen në data 22 dhe 23 gusht 2022.

Departamenti i Arteve

Përgjegjësi, Dr. Rubin Mandija